

Frrok KRISTAJ

Justiniani dardan - Perandor i Bizantit

Pozita gjeostrategjike e trojeve etnike iliro-shqiptare ka imponuar që gjatë historisë popujt e këtyre viseve të ballafaqohen me luftëra të mëdha. Bile qysh në kohën ilire janë ngritur mbretëri fisesh (ilire) në krye të të cilave kanë qenë mbretër eminentë. Në anën tjetër, nga gjiri i ilirëve në kohën e perandorisë romake, përkatësisht të Perandorisë Romake të Lindjes-Bizantit kanë dalë perandorë që u kanë bërë ballë sulmeve barbare të popujve joballkanikë, pastaj ata i kanë dhënë organizim të ri shoqëror, kulturor e ideor-fetar perandorive të tyre (romake e bizantine). Vargu i perandorëve ilirë që u gjendën në ballë të Perandorisë Romake filloi me Decin, mbret i Romës. Ndërkaq, perandori i parë ilir që u gjend në krye të Perandorisë Romake ishte Kaludi II (u shpall perandor në vitin 268 të kohës së re), pastaj Aurelani, Probi, Diokleciani, Maksimiliani, Konstanc Klori, Konstandini i Madh me tre djemtë e tij Konstandinin II, Kostancin e Julianin. Më vonë edhe një herë katër burra të gjakut ilir, durrsaku Anastasi I (491-518), Justini I (518-527), Justiniani (525-565) dhe Justini II (565-578) arritën të marrin timonin e Perandorisë Romake të Lindjes-Bizantin, të cilët edhe u përpoqën ta ringjallin madhësitinë e dikurshme të Perandorisë Romake. Natyrisht se këta perandorë me veprat e tyre lanë gjurmë të pashlyeshme në histori, por lanë gjurmë edhe në kulturë, në organizim të perandorive të tyre.

Kësaj radhe do të ndalemi te pjesa e vjetër e Dardanisë, Gallapi, nga kanë dalë shumë figura historike iliro-dardane, si Shën Flori e Shën Lauri, Shën Niketë Dardani, Konstandini i Madh, si dhe Justini I, Justiniani i Madh dhe Justini II.

Shën Flori e Shën Lauri

Tradita dymijëvjeçare e krishterimit në trevat iliro-dardane, nuk mund të mos i falte gjatë shekujve edhe shenjtore vendas. Kështu, Shën Flori dhe Shën Lauri (që ishin nxënës të Prokulit e të Maksimit), ose Floriani dhe Laurini, siç njihen shpesh dy vëllezërit binjakë, jetuan në Dardani gjatë gjysmës së parë të shekullit II. Ata ishin gurskalitës. Me pëlqimin e sundimtarëve vendës, ngritën një kishë të krishterë, të cilën ia kushtuan Jezu Krishtit. U martirizuan në Ulpianë, duke mbrojtur kështu tokën e të parëve tanë me gjak të derdhur për të dëshmuar Krishtin (Mijović P. Flor i Lavr - Neimari i kamenoresci iz Ulpiane, në GMKM VII-VIII (1962-63), 339-353; Dragutinac M. Flor i Lauro, në "Leksikon ikonografie, liturgike i simbolike zapadnog krscanstva, Zagreb, 1979, 230).

Rrafshlarta në pjesën qendrore të fshatit Dabishec quhet kodra e Florit. Për etimologjinë e kësaj rrafshlarte ka mendime të ndryshme. Disa studiues mendojnë se emri i kësaj rrafshlarte i përket botanikes, kurse të tjerët duke pas për baza numrin e kishave për rreth dhe afërsinë me Brekovicën mendoj se ky emërtim mund të lidhet dhe me Shën Florin si martir të krishterimit në Dardani. Edhe sot në Gallap ekziston emërvendi Kodra e Florit.

Shën Niketë Dardani

Niketë Dardani (340-414) ishte letrarë dhe muzikanti më i njohur i të gjitha kohërave për kompozimet sakrale. Ky dijetar dhe muzikant i kryehershëm i traditës sonë kishte lidhje miqësore më personalitetet më të shquara të kohës në Evropë, si me Aurel Ambrosin,

ipeshkëv i Milanos, më filozofin Agostin e Iponës, më poetin Paloin Nolani, më papë Inoçentin I e shumë të tjerë.

Ndër krijimet më të njohura të kompozimeve të Niketës çmohet sidomos himni “Te Deum, laudeamus” (Ty o Zot të lavdërojmë), “De psalmodiae bono” e shumë të tjera, të cilat kanë rëndësi të madhe për historinë e traditës sonë kulturore e artistike, qoftë si përmendore të hershme të muzikës dhe muzikologjisë, qoftë si vepra të zgjedhura në repertorin paleokristiane të mbarë botës.

Të paktën që nga fillimi i shekullit të kaluar, kur britaniku A. E. Burn botoi në Cambridge (1905) monografinë “Niceta of Remessiana”, dihet botërisht se ky shenjtor doli prej botës iliro-shqiptare. Vetë Shën Niketa shkruan: “Dardanus sum” - jam dardan.

Shën Konstantini i Madh

Konstandini (i biri i Konstant Klorit dhe Helenës), u lind rreth vitit 280 në Naissus të Dardanisë, Nishi i sotëm (tash në Serbi), dhe vdiq më 22 maj 337. Ai ishte i njohur si Konstandini i Madh apo Konstandini I. Ishte perandor romak prej 306 deri 337. Asnjë perandor romak nuk ka lënë gjurmë më të thella në kishën e krishterë se sa Konstandini. Ai u lejoi të krishterëve ushtrimin e lirë të fesë (me Ediktin e Milanos, 303). Në këtë mënyrë Konstandini përfaqëson kalimin nga antikiteti pagan në mesjetën e krishterë. Përndryshe, me emrin e tij u pagëzua Stambolli i sotëm dhe emrin Konstandinopol e mbajti plot 16 shekuj.

Vendlindja e Justinianit të Madh

Bërvenikun, qytet-treg e gjejmë të regjistruar me emërtimin Bruenico, Bruenich e Breuenicho dhe e ndeshim për herë të parë në vitin 1280, kohë kjo kur Bërveniku përmendet si koloni e Kotorrit, përkatësisht e Raguzës. Atëbotë në Bërvenik përmendet edhe Kisha e Shën Trifunit, që u ka shërbyer besimtarëve katolikë. Sipas Jeriçekut çdo vend xehetar e ka pasur kishën e vet katolike. I pari që u përcaktua për ekzistimin e Bërvenikut në anën lindore të lumit Llap ishte Ilarion Ruvaraci, përfaqësues i historiografisë kritike serbe. Në vitin 1879, Ruvaraci tha: “Nuk mund të mendohet për Bërvenikun e rrjedhës së Bërvenicës në Ibër, meqë rruga nga Prishtina ose Graçanica për Manastirin e Ravanicës nuk shpie kah Bërveniku i Ibrit”. Një mendim të tillë e mbështet edhe Konstantin Jeriçek në “Studime mbi rrugët tregtare”. Këto konstatime u pranuan dhe nga studiuesit Stojan Novaković, Avram Popović, Stojan Stojanović, Vlladimir P. Petković, Petar Kosanić, Mihajlo Miladinović, Emil Çerškov, D. Kovačević-Kojić, A. Urošević, I. Manken, historiani ynë Jahja Drançolli e kështu me radhë. Historiani ynë i mirënjohur, Jahja Drançolli, argumentet e veta i mbështet në diplomën e perandorit Stefan Uroshi, të 15 qershorit 1363. Nga kjo del se Bërveniku si treg dhe xeherore ka ekzistuar në rajonin e Gallapit edhe gjatë periudhës mesjetare. Ndaj, dihet mirëfilli se në periudhën paraosmane nga Shatorica (vend në Kopaonik mbi Bellasicë) është zgjatuar një rrugë e cila është degëzuar në dy drejtime, që është fjala për “rrugën e xehetarëve”, një drejtim i së cilës shkonte për në Bellasicë dhe nga andej lëshohej në Llapin e Poshtëm dhe arrinte në Bërvenik. Të dhënat në terren bëjnë fjalë për ekzistimin e Bërvenikut si qytet në rajonin e Gallapit, ngase kodra që ngrihet në kufijtë e fshatrave Brainë dhe Bërvenik edhe sot nga disa qytetarë quhet Çuka e Brainës, kurse nga të tjerët Çuka e Bërvenikut.

Po ashtu, në afërsi të Bërvenikut janë zbuluar disa vendshkrirje xehesh si në Bërvenik, Brainë, Ballaban, Keqekollë, Koliq, Grashticë, Herticë dhe fshatra tjera, të cilat dikur lidheshin me rrugët që qonin në minjerat e Artanës, Trepçës dhe Bellasicës. Vlenë të përmendet se një rrugë e xehetarëve, që vinte prej Artanës nëpër Gjytetin e Grashticës, kalonte nëpër Shator (kodër e ngritur me të cilën sot kufizohen fshatrat Keqekollë, Radashec dhe Koliq), që shpien nëpër Kështjellën e Sharbanit, kah Suka e Madhe dhe Suka e Vogël, në Rimanishtë, dhe qon në pjesën e poshtme të lumit Llap në Besi apo Lluzhan, e që pastaj në anën verilindore të rrjedhës së Bërvenicës arrin në qytetin mesjetar të Bërvenikut. Lidhja e këtyre dy vendeve bëhej edhe përmes rrugës tjetër të xehetarëve, që kalonte nëpër Kështjellën e Kollçakut (në Koliq) kah Trojet e Gjenovizit dhe Quka e Zallit (në Ballaban) dhe arrinte në Bërvenik. Nga kjo kuptojmë se nuk është fjala për Shatoricën mbi Bellasicë, por për Shatorin në Malësinë e Gallapit.

Po ashtu, toponimet që dëshmojnë për lashtësinë e Bërvenikut dhe të fshatrave për rreth veçojmë: Quka e Bardhë, Quka e Hajrushit, Quka e Fezës, Goleshi, Kisha e Bërvenikut, Kisha te Zallina, Kisha e Goleshit dhe Trojet e Gjenovizit në Bervenik, kurse në fshatin Brainë veçojmë Qukën e Brainës me kështjellën ngjitur me Bërvenikun, në të cilën vërehen muret e kështjellës, themele, tulla, gjurmë rrugësh, enë çeramike të ndryshme e vegla pune, që dëshmojnë për ekzistimin e një qytetërimi antik dhe mesjetar. Shumica e studiuesve mendojnë se Kështjella e Brainës është Bederiana e rindërtuar nga Perandori Justinian. Në Brainë i hasim edhe këto toponime: Quka e Zhigut, Quka e Madhe, Kisha, Lugu i Kishës (që ka edhe ngjyrë metalesh) etj.

Edhe në fshatin Kalaticë, që kufizohet me Bërvenikun, ka gjurmë të objekteve të banimit, si ato te Ara e Shtogjeve, te Përroni i Zidinave, Vorresat e krishtera etj. Në Ballaban po ashtu ka ngjyrë metalesh te Përroni i Samakovës, Trojet e Gjenovizit, Quka e Zallit, Përroni i Gomurit, që me rrugën nga Bërveniku lidhen me Kështjellën e Kallçakut dhe kështjellat tjera për rreth.

Territori i Gallapit ishte nyjelidhëse e shumë rrugëve që mundësonin lidhje më të shkurtëra me shumë qytete e qendra tregtare të kohërave më të hershme. Rruga Nish-Shkup e shënuar vetëm pjesërisht në Tabula Peutingeriana, që shkonte nëpër një varg lokalitetesh të antikës së vonë, kalonte malet e Gallapit dhe hynte në pellgun e pjesës më burimore të Moravës së Jugut, duke u bashkuar në afërsi të vendbanimit antik Station vectigalis Illyrici në fshatin Runjevë, me rrugën që nga drejtimi i Ulpianës shpinte në Shkup. Ndër rrugët e rëndësishme të lashtësisë ishte edhe rruga Naissus-Lissus, e cila kalonte nëpër kufirin veriperëndimor të Gallapit dhe rruga Nish-Medvegjë-Shkup, që kalonte nëpër pjesën qendrore të Gallapit. Nëpër Gallap kalonin edhe rrugët Ulpianë-Urlanë-Tullarë-Medvegjë dhe rruga Magurë-Lipian-Banullë-Janjevë-Artanë-Medvegjë-Leskoc, që lidheshin me rrugët tjera ndihmëse të cilat kalonin nëpër rrafshlartat e Gallapit, si Zllash, Shator, Brain-Bërvenik, Drazhnjë, Balloc e Kodra e Gollakut, që shpinte në drejtim të Nishit.

Po ashtu, rruga për Brainë e Lisinë, të cilat lidheshin me luginën e Jabllanicës, e që nga ana e djathtë, zbriste në të majtë të Siarinës, kurse në të djathtë qonte në Kitkë për të vazhduar në drejtim të Shkupit. Rrugë tjetër nga Artana për në drejtim të Shkupit ishte ajo që kalonte nëpër Përlepnice të Gjilanit dhe rruga Artanë-Gllamë-Zhegoc-Zhiti-Kllokot, e cila lidhej me rrugën Ulpianë-Shkup. Përveç këtyre kalonin edhe rrugët nëpër rrjedhat e lumenjëve, që lidheshin me rrugët kryesore që qonin në Artanë dhe qytete tjera xehetare përreth Artanës, si rrugët që ndiqnin degëzimet e lumit Krivareka (kështu e

quajnë serbët) dhe rruga Prishtinë-Grashticë-Keqekollë-Lisinë. Një degëzim tjetër i kësaj rruge ndahet në Grashticë që shkonte në drejtim të Janjevës. Nga të dhënat e periudhës Antike e të Mesjetës kuptojmë se ka ekzistuar qyteti xehetar e tregtar i Bërvenikut në Malësinë e Gallapit.

Favius Pjetrus Sabbatius - Justiniani i Madh

Nga vargu i perandorëve (romak e bizantin) të gjakut ilir kësaj radhe po shkëpusim nga historia Favius Pjetrus Sabbatius, përkatësisht Justinianin e Madh, perandor i Perandorisë Romake të Lindjes-Bizantit. Koha e Bizantit në historinë tonë njihet si kohë e errtë mu për shkak se okupatorët që erdhën në këto vise, sidomos sllavët, turqit e prapë sllavët, u munduan të na grabitin edhe historinë, traditën dhe figurat botërore që i dha gjaku i të parëve tanë. Këtë na e bënë për të na cilësuar ardhacakë. Në fakt, ardhacakët sllavë i përvetësuan kishat, shenjtërit, kurse turqit na e zhdukën kulturën dhe qytetërimin fetar e kombëtar.

Justiniani i Madh, perandor i Bizantit nga viti 527-565, ishte ilir. Të përmendim faktin se vetëm në rajonin e Llapit të tashëm u ndërtuar Kështjella e Laberiumit, kurse u rindërtuan kështjellat në Tezule, Besiana, Labuca dhe Bederiana. Lidhur me Bederianën Prokopi shkruan: “Diku në krahinën e dardanëve të Evropës, përtej kufirit të Bederianës, ishte vendbanimi Taurisium (Vërejtja jonë: Turuçica e sotme), përkatësisht aty afër ndodhet edhe vendbanimi Tullar, si dhe Tauri, afër Kështjellës së Bederianës. Aty u lind Perandori Justinian... Në afërsi të këtij vendi ndërtoi një qytet të bukur, të cilin e quajti Justiniana Prima... (Vizantiski izvori za istoriju naroda Jugoslavije, bleni I, Beograd, 1955, faqe 54-61, përkatësisht Fehmi Pushkollu “Llapi gjatë historisë”, Prishtinë, 1998, faqe 37).

Ishte pagëzuar me emrin Pjetrus Sabbatius, kurse emrin romak përkdhelës Justinianus ia kishte dhënë axha i tij - Justin I, perandor i Bizantit nga viti 518-527, i cili e kishte marrë në Konstandinopol dhe së pari ia kishte dhënë pozitën e lartë të patricit e më vonë edhe e kishte emëruar në gradën e pallatit perandorik si “magister equitum et peditum preasentalis”. Justiniani me kalimin e kohës u bë edhe këshilltar i axhës për çështje të politikës së brendshme e të jashtme. Në vitin 525 fitoi titullin caesar, kurse më 4 prill të vitit 527 arriti të bëhet perandor, kur edhe gruaja e tij Theodora u kurorëzua si Augusta (Justiniani u kurorëzua me Theodorën në Katedralën e Shën Sofisë, në vitin 525, kurse më 4 prill 527 u kurorëzua si bashkëperandor - bashkëperandoreshë).

Në fakt, Theodora ishte perandoresha më e aftë e Romës. Ajo ushtroi ndikim në udhëheqjen e politikës së bashkëshortit. Në veçanti dallohet si artizane e lëshimeve ndaj monofiziteve, e sidomos të përfshirjes në legjislacionin e Justinianit të shumë ligjeve që kishin të bëjnë me mbrojtjen e grave, problemet e divorcit, si dhe mbrojtjen e prostitutave.

Formalisht sundimi i tij si perandor bizantin njihet nga viti 527, mirëpo ai që nga vitit 518 ishte bashkëperandor me axhën e tij Justinin I. Justiniani ishte nip i Justinin I, pasi që e ëma e tij ishte motra e perandorit Justinin I. Justiniani ishte perandor 38 vjet, përkatësisht në kohën kur ishte edhe si bashkëperandor, ai qëndroi në fronin perandorak 47 vjet. Perandori Justinian vdiq më 1 gusht 565, kur edhe u trashëgua nga nipi i tij Justinin II, i cili sundoi deri në vitin 578. Me Justinin II definitivisht përfundon edhe Dinastia e Justinin I dhe e Justinianit, që zgjati nga viti 518-578, përkatësisht plot 60 vjet.

Perandori Justinian, si njeri me karakter të fortë, energji dhe inteligjencë cilësore, hodhi poshtë konzervatizmin tradicional bizantin. Gjatë sundimit të tij mbi Italinë, Afrikën Veriore, Sardenjën, Korsikën, Ishujt e Balearit e të Ceutenës, Persinë, Spanjën e kështu me radhë, këto vende i solli prapë nën sundimin perandorak.

Reformat administrative të Justinianit kishin për qëllim forcimin e autoritetit imperial, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit dhe mbledhjes së taksave.

Perandori Justinian në botë njihet për tri gjëra që kanë lënë gjurmë në historinë botërore, pra njihet si themelues i botës së qytetëruar, përkatësisht i sistemit legal të civilizimit, njihet për normat juridike të quajtura Corpus Juris Civilis e të njohura edhe si “Kodi i Justinianit” (të shpallur në vitin 529) dhe së fundi njihet për ndërtime e rindërtime.

Ai (Justiniani) gëzonte përkrahje të madhe në realizimin e planeve të tij nga gruaja e vet Teodora, si dhe bashkëpunëtorët e tij të talentuar të lëmisë së drejtësisë, administratës, mirëqenies, arkitekturës, ndërtimitarisë e të tjera.

Justiniani i la në trashëgimi njerëzisë një perandori me monumente më të avancuara në trajtë të Shën Sofisë, pastaj ligjin e tij - Kodi Justinian, që edhe në kohën më bashkëkohore është bazë për sisteme të civilizimeve.

Ëndrra e Justinianit për ripërtrimjen e Perandorisë Romake në shtrirjen e saj të mëparshme, si dhe fama e tij në aspektin materiale e kulturore, bëri që Konstandinopolin (që e kishte themeluar perandori ilir, i lindur në Nish, Konstadini i Madh), ta shndërroi në qendër të zhvilluar dhe të lulëzuar në botë.

Justiniani nip i Justinit të parë

Justiniani i Madh ishte nip i Justinit të parë, që ishte nga Nikja e Dardanisë Ilire. Xhaxhai i tij Justini u tregua udhëheqës i paaftë. Justiniani e udhëhoqi Perandorinë qysh para se të kurorëzohej si perandor (527-565). Justiniani u ngrit në fronin perandorak në moshën 40-vjeçare.

Për të zhvilluar perandorinë në pjesët tjera, Justiniani i dha një çmim të lartë në vitin 532 Shahut pers Kusros I. Mirëpo përbrenda kishte trazira siç ishin kryengritja e Nikesë, që shpërtheu në Konstandinopol, në janar të vitit 532. Pas disa çrregullimeve politike, Belisari hyri në Hipodrom me ushtri dhe e shuajti revoltën e "të gjelbërve" dhe "të kaltërve". Më këtë rast u shkaktua një gjakderdhje dhe qyteti pësoi dëmtime të rënda, mirëpo në anën tjetër kjo i hapi rrugën Justinianit për zbatimin e programit të tij. Kështu ai pas revoltës filloi punimet për ndërtimin e kishës së re në vend të kishës së dëmtuar rëndë të Haja Sofies.

Në vitin 533 Justiniani ndërmori disa ekspedita të udhëhequra nga Belisari kundër mbretit vandal në Afrikë. Armata që ia kishte vënë Justiniani në dispozicion Belisarit përbëhej prej më se 10 mijë këmbësorëve edhe nga më se 5.000 kalorës dhe 3.000 barbarë që konsideroheshin si aleat. Me fitoret e arritura kundër Gelimerit, i cili kishte mbajtur një pjesë të ushtrisë dhe një pjesë e kishte dorëzuar nën komandën e të vëllait Tata, në ishullin e Sardineve, Belisari arriti ta pushtoj Karagen për një kohë të shkurtër. Pas kësaj fitoreje Belisari u kthye së bashku me robërit e zënë në Konstandinopol ku Justiniani i la të vendoste për sundimin në Afrikë.

Sulmin e gotëve të jugut, Justiniani e bëri me zbarkimin në Itali në vitin 535. Ushtria e udhëhequr nga Belisari nuk hasi në ndonjë qëndresë deri në Palermo dhe më 31 dhjetor të vitit 535 hyri në Sirakuzë. Në pjesën tjetër të kohës ai përparoi me ushtrinë e vet deri në Napol ku ishin garnizonet e gotëve të cilët i theu. Në dhjetorin pasues Belisarin e gjejmë

me ushtri të ngulitur në Romë duke u përgatitur për kundërsulmin e gotëve të jugut. Pas një viti rrethimi të Romës me ndihmat e marra nga Justiniani, Belisari vazhdoi marshimin e tij me të njëjtën ushtri drejt Ravenës, ku hyn në vitin 540. Justiniani që kishte për qëllim zbatimin e planit të tij, pranoi një mbretëri të gotëve të jugut në pjesën veriore të Italisë ashtu që të siguronte këtë pjesë të perandorisë dhe të qëronte hesapet me perandorinë persiane në jug të kufinjve.

Më 540, Khusroi u hodh me ushtri në Antioki dhe e pushtoi. Në vitin 541 Justiniani e dërgon Belisarin në vijën e frontit, mirëpo Khusroi ishte përqendruar në Lazaricë ku Lazi, një pirës armen, kishte krijuar një lidhje të fuqishme. Luftërat bizantino-perse në këtë kohë vazhduan deri në vitin 561 kur u bë një marrëveshje, kurse pjesa lindore e Detit të Zi i takonte Perandorisë së Justinianit.

Prapë Justiniani vendosi që të dërgonte Belisarin në pjesën perëndimore dhe e rimori Romën në dhjetor të vitit 546, mirëpo menjëherë pasi repartet e Belisarit hynë në Romë, ai mori urdhër nga Justiniani që të ndërmerre një ekspeditë kundër rebelëve në Siçili.

Më 550 Justiniani emëron prijës të ekspeditës më të madhe në Itali, kushëririn e vet Germanusin, i cili gjen vdekjen aty nga një sëmundje. Në vend të tij Justiniani vë Narsin, i cili po ashtu ishte një udhëheqës i aftë me një karrierë ushtarake të ndritshme. Ky arrin që t'i mund gotët në vitin 552.

Gjatë kohës së sundimit të Justinianit, Perandoria Bizantine arrin kulmin e lulëzimit në të gjitha lëmenjtë e jetës dhe jo vetëm në kulturë, si ishte e njohur më parë dhe pas Justinianit. Gjatë kësaj kohe u hartua edhe Kodi i Justinianit (528), i cili u institualizua dhe hyri në fuqi rreth vitit 534.

Justiniani vdiq më 565. Ai i kishte dhuruar Perandorisë Bizantine çastet më të ndritshme në historinë e saj. Gjatë kohës së tij perandoria shtrihej nga Armenia deri në brigjet e Spanjës e nga Danubi deri në Afrikë. Detin Mesdhe e shëndrroi në një Liqe Bizantin. Vdekja e tij i hapi rrugën perandorit që mbante emrin e tij Justini II.

Pra, Justiniani kishte arritur atë që nuk e kishte bërë asnjë perandor tjetër romak, ngase ai e kishte pushtuar pothuajse gjithë zonën e Mesdheut, që shtrihet përtej Lindjes së Mesme (e cila ishte vet bizantine), përgjatë brigjeve evropiane dhe atyre afrikane. Perandoria i kishte fituar përsëri pothuajse kufinj të kohës së Oktavianit, përkatësisht këta kufinj ishin fituar vetëm nga Justiniani i Madh. Bizanti ishte kthyer në superfuqi të vetme të Mesdheut (shekulli VI), që do të thotë se Mesdheun e mbizotëronte Pax Bizantina.

Justiniani ia kishte aritur qëllimit të tij - rikthimin e triumfit romak (reconquista), por pasardhësi i tij nuk ishte i aftë ta ruaj këtë fuqi. Pavarësisht nga fitoret e Herakliut kundër Persisë dukej se Bizanti ishte i dënuar që ta mblidhte fuqinë e tij në Azinë e Vogël, në viset greke dhe në viset Dardanisë Ilire të Ballkanit.

Justiniani adaptoi përfundimisht krishterimin në një religjion të vetëm në shtetin bizantin. Ai kishte vendosur një unitet në kishën e krishterë. Kishte ngritur monumente madhështore, si Kishën e Shën Sofisë, Shën Irenës, Kishën e Shenjtorëve Sergio e Baku, që ia ndërruan pamjen e deriatëhershme të Konstandinopolit, i cili qytet në atë kohë ishte bërë edhe port kryesor i tregtisë ndërmjet Evropës dhe Azisë. Bile, në vitin 552, kur disa murgj kishin sjellë vezët e krimbit të mëndafshit, Justiniani kishte ngritur industrinë e mëndafshit, e cila u bënë ndër më fitimprurëset e perandorisë.

Megjithatë, lindja e një feje të re në Mesdhe, Islamit, dhe ndarja e të krishterëve, kisha dhe sekte, u bënë shkak që të bëhet një rindarje e fuqive në Mesdhe dhe në Evropë.

Fundja, kontributi i Justinianit ishte tepër i rëndësishëm edhe në çështjet kishtarë. Në Konstandinopol qytetarët ishin të ndarë në “demo”, të cilët përkrahnin edhe grupet e ndryshme sportive që aktivizoheshin në arenën e qytetit. Fillimisht veprimtaria e këtyre grupeve (demo) u duk vetëm si sportive, por me kalimin e kohës filluan të shprehin edhe mendimet politike e fetare. Demot më të shquar ishin “të gjelbërit” (Ortodoks, aristokrat) dhe “të kaltërit” (monofiset, besonin se Jezusi ishte vetëm Zot), pastaj vinin “të bardhët”, që ishin aleatë të “të gjelbërve” dhe të “kuqët”, aleat të “të kaltërve”.

Ndaj për shumë historianë Justiniani edhe mbeti perandori i fundit romak, që do të thotë se Justiniani ishte perandori më i shquar i Perandorisë Romake. Prandaj shkaqet kryesore që Justinianin e vendosin midis të mëdhenjve të Romës ishin: Veprat e mëdha të artit dhe infrastruktura e ndërtimeve, pastaj kodimi i drejtësisë romako-bizantine, politika e tij ushtarake, si dhe ndërtimet dhe rindërtimet.

Ndërtimet

Duket se në kohën e Justinianit perandoria kishte përjetuar një zhvillim ekonomik dhe kulturor të madh. Sidoqoftë nga aspekti historik çdo gjë që mundi të nxjerrë në pah kjo perandori, që nga Konstandini i Parë e deri te Konstandini i fundit, pasqyrohet më mirë në kohën e Justinianit të Madh, përkatësisht veprat e ngritura në kohën e Justinianit të Madh, kalojnë në numër dhe madhësi të gjitha mbetjet e dinastive të tjera bizantine. Madhështore ishte edhe veprimtaria e Justinianit mbi ndërtimin e mureve mbrojtëse në viset kufitare veriore - Danub, zonat kufitare lindore (Biminak deri në Detin e Zi) dhe zonat juglindore (Eufrat). Përndryshe Perandori Justinian njihet edhe për ndërtime e rindërtime - fortifikoi 44 caqe e rindërtoi 68 (dikund thuhet 69) të tjera në Epir, Maqedoni e në Dalmaci Ilire.

Kodi i Justinianit

Në fushën e legjislacionit, prej vitit 528 dhe deri në vitin 534, u hartua Kodi i Justinianit që harmonizoi dhe modifikoi të gjithë legjislacionin e vjetër. Vlera e tij për qytetërimin perëndimor është e pallogaritëshme, sepse në formën që e sjellë prej Justinianit, filloi të përdoret në Evropë që nga shekulli XII (*Luan Përzhita “Dy kolosët e Dardanisë”, Albanica, nr. 61, Prishtinë, 2006, faqe 70-73*).

Kodit të Justinianit iu dha autoriteti statutar në vitet 533-534. Prej asaj kohe ekziston edhe termi “kodifikim”, që ka të bëjë më një proces të grumbullimit dhe të rregullimit të ligjeve në një sistem të unifikuar normash juridike të shkruara dhe të proklamuar. Në fakt, Corpus Juris Civilis - Kodi i Justinianit është një monument në historinë legale të jurisprudencës botërore. Me paraqitjen në trajtë sistematike të rezultateve mijëvjeçare të së drejtës romake Kodi i Justinianit u bë bazë për sistemin bashkëkohor të ligjit civil. Justiniani bëri klasifikimin dhe rikrijimin e kushtetutave nga perandorë të ndryshëm romakë në një kod të veçantë që përbëhej nga 4.652 ligje. Ai po ashtu e bëri përmbledhjen prej 50 vëllimeve të vendimeve kryesore që kishin qenë në përdorim qysh nga juristët e shekullit II e III të kohës së ligjit romak. Me ligjet e Justinianit për herë të parë ishin liruar skllavët dhe ishte lejuar shitja e tokës, ishte siguruar barazia e të pasurëve me të varfërit, ishte siguruar mbrojtja e qytetarëve e kështu me radhë. Ligji, kishte thënë Justiniani, është arti i mirësisë dhe i drejtësisë. Puna e më vonshme legjislative e Justinianit (deri në vitin 565) është e njohur si “Novela Constituciones” pastaj ishte siguruar që “Corpus Iuris Civilis” të dalloj nga “Corpus Iuris Canonika”

romake. Bile, nuk është e tepërt të thuhet se asnjë libër nuk ka lënë gjurmë në historinë e njerëzimit sa Corpus Iureis Civilis i Justinianit. Kjo vepër përmban të gjitha ligjet e kodifikuara të Justinianit në 2.200 faqe të lidhura në tri vëllime tani të standardizuara në botimin e “Berlinit”. Nga kjo del se Perandori Justinian ishte ndër figurat më kreative dhe më të larta në historinë e jurisprudencës botërore. Kjo punë monumentale e Justinianit inspiroi edhe sisteme legale të shteteve evropiane. Në fakt, diturisë legale juridike të Romës së vjetër i dha ngjyrë plotësisht të re doktrina juridike e Justinianit. Justiniani thoshte “Edhe vetë autoriteti perandorak duhet t’i përkulet ligjit”.

Përndryshe, para epokës së Justinianit të Madh Drejtësia Romake kishte probleme për vet shkakun se ekzistonin shumë burime juridike midis të cilave gjykatësit duhet të zgjidhnin se cili ligj ishte i drejtë për rastin e caktuar dhe cili jo. Problemi i drejtësisë e kishte shqetësuar edhe Konstandinin e Madh, i cili nuk kishte gjetur zgjidhje, kurse Teodosi i Dytë dhe Valentiani i Tretë e kishin bërë një zgjidhje, sipas të cilës gjykatësit duhej t’i drejtoheshin një trupi gjykatësish të cilët e jepnin mendimin e tyre. Kjo mënyrë e ndarjes së drejtësisë ishte aq problematike sa që e detyroi Justinianin t’i mbledh të gjitha ligjet në një kod të përbashkët ligjor, i cili do ta përcaktonte me qartë çdo vepër kundërvajtëse si dhe do ta përcaktonte ndëshkimin për te. Për t’ia aritur qëllimit, Justiniani vendosi (më 13 shkurt 528) një grup prej 10 këshilltarësh juridik me kryetar Tribonianin. Detyrë e këtij grupi ishte që të mbledhte çdo normë juridike nga ligjvënësit e parë romak (si Gaiusi, Adriani etj.), në mënyrë që të gjenin ndëshkimin e caktuar. Vepra përfundoi pas një viti dhe ngeli e njohur si Codex Justinianus. Codex Justinianus përbehej nga 12 libra të ndarë në kapituj të shkruar në gjuhën latine. Përveç ligjeve të vjetra, ekzistonin edhe vendime të Justinianit për tema të cilat nuk ishin prekur nga ligjvënësit e mëparshëm. Bashk me Kodin dolën në qarkullim edhe “pesëdhjetë përgjigje” (Quinquaginta Decisiones). Pas këtyre Justiniani vashdoi në krijimin e Hyrjeve (instituta) dhe të Rejave (Neare). Të Rejat u shkruan në gjuhën greke, derisa deri atëherë gjuha zyrtare e Perandorisë ishte ajo (gjuha) latine. Do përmendur se Justiniani e kishte kuptuar rëndësinë e përdorimit të të gjuhës greke për shkak se popullata e Bizantit atëbotë e fliste më shumë gjuhën greke (Justiniani nuk e fliste gjuhën greke). Pikërisht për këtë Justiniani quhet perandori i fundit romak pasi që pas tij udhëheqja e Bizantit ngadalë do t’i humb karakteristikat romake, përkatësisht latine. Ndaj kur Bizanti sipas gjuhës do të jetë kthyer “në pronë greke” shumë historianë do ta vëjnë në dyshim karakterin perandorak të Bizantit, sepse atë periudhë do të fillojnë ta quajnë mbretëri.

Vepra me rëndësi të madhe historike botërore e ligjvënësve të Justinianit do të mbetet bazë e drejtësisë romake që do të zbatohet në Bizant deri në vitin 1453. Gjithashtu me punën e Justinianit (Corpus Juris Civilis) drejtësia romake u bë më “njerëzore”, sepse ishte hera e parë kur kërkohet që gruaja mund të ndahej nga burri, pastaj kërkohet që gratë të marrin pjesë në trashëgimi, të njihet e drejta e fëmijëve të jashtëligjshëm etj. Po ashtu, ishte hera e parë në historinë e njerëzimit kur ligjeve njerëzore i jepej prejardhja te Zoti dhe kur ndarja e drejtësisë quhej si një vepër e shenjtë. Drejtësia romake, ashtu siç ishte kodifikuar nga Justiniani i Madh, mbetet deri më sot baza e ligjeve të pjesës më të madhe të vendeve të Evropës, bazë juridike e shumë shteteve të Afrikës dhe Amerikës latine, bazë e Kebekut si dhe e Luizianes të SHBA-ve (*Nikollë Loka “Dinastitë iliro-shqiptare me famë botërore”, Mirdita, Tiranë, 2004, faqe 78-86*).

Nga kreu kjo del se veprat e Justinianit, si “Digestin”, “Kodi” dhe “Institutet”, si një trup

zhvilimor i normave shoqërore të Justinianit, bëjnë pjesë në “datat më të rëndësishme të drejtësisë botërore të të gjitha periudhave kohore”.

Kanunet kanë bazë te Kodi i Justinianit

Dhe, tani shtrohet pyetja ku mbetën krejt këto norma juridike që u hartuan nga Justiniani ynë i Madh, e të cilat i njeh bota e ne jo, të cilat bota i ka të shkruara e ne jo dhe bota i ka në histori e ne jo? Ato norma, në të clat thirret bota, na i zhdukën okupatorët, ata që tentuan të na e zhdukun edhe historinë, dhe ne tani ato vlera i marrim nëpërmjet të të huajve dhe nga historitë e të huajve.

Megjithatë, ato norma mbetën në kujtesën e brezave tona dhe u trashëguan me mbamendje, që më vonë, të reformuara sipas kohës dhe mjedisit, u bartën dhe u cilësuan si Kanuni i Arbërisë, përkatësisht i Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Më pastaj, njihet Kanuni i Labërisë, Kanuni i Maleve, kanunet e katundit Kastrat (1891-1892), marrëveshja në mes të Shalës dhe Nikajt (1850), Besëlidhja ndërmjet Shalës, Shoshit, Nikajt e Merturit (1894), marrëveshja në mes Nikajt e Currajt (1895), vendimi i katundit Vukël (1902), Kanuni i gjashtë bajraqeve të Dukagjinit (1913) e të tjera, të gjitha të pashkruara e deri te Kanuni i Lekë Dukagjinit, që e voli nga populli dhe e kodifikoi Atë Shtjefën Gjeçovi (u botua si vepër postume më 1933). Albanologu Milan Shuflaj supozonte se ky kanun duhet të jetë kodifikuar nga bashkëluftëtari i Gjergj Kastriotit - Lekë Dukagjini, zotërimet e të cilit kapnin një sipërfaqe nga Zadrima e Sipërme e deri në Ndërfand e nga aty deri ku bashkoheshin dy Drinat (Drini i Bardhë dhe Drini i Zi). Në fakt, të gjitha këto norma kanunesh supozohet se në një farë mënyre janë mbamendje të brezave që nga normat juridike të Justinianit të Madh.

Prishtina e mban emrin e Justinianit

Në vitin 518 Ulpiana u rrënua plotësisht nga një termet i madh. Këtë qytet - Ulpianën antike e ngriti Perandori i Madh bizantin Justiniani dhe e quajti Justiniana Secunda, kurse më vonë ky emërvend u transformua në Istriniana, përkatësisht Pri (që do të thotë qytet) Istriniana, pastaj Pristrina dhe së fundi Prishtina, që do të thotë Qyteti i Justinianit.